



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I NDIHMËS SHTETËRORE**

V E N D I M

Nr. 27, datë 18.08.2008

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 25, DATË 02.05.2008 “PËR
PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE PËR PËRJASHTIMIN
NGA AKCIZA TË LËNDËVE DJEGËSE, TË PËRDORUARA PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TERMOCENTRALET ME
FUQI MË TË MADHE SE 5MW”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e :

- | | |
|----------------------|-----------|
| - Z. Genc Ruli | - Kryetar |
| - Znj. Mimoza Dhëmbi | - Anëtar |
| - Z. Viktor Gumi | - Anëtar |
| - Znj. Mimoza Vokshi | - Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 18/08/2008, pasi shqyrtoi argumentet e paraqitura nga Drejtoria e Politikave Elektro-Energjetike, lidhur me kushtet për zbatimin e Vendimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 25, datë 02.05.2008, për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për përjashtimin nga akciza të lëndëve djegëse, të përdorura për prodhimin e energjisë elektrike nga termocentralet me fuqi më të madhe se 5MW”, mbështetur në nenin 128 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 19 dhe nenin 22, pika 2, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për Ndihmën Shtetërore”,

VENDOSI :

1. Në vendimin nr. 25, datë 02.05.2008 të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, pikat 1 dhe 2 ndryshohen, si më poshtë:

“ 1. Skema e përjashtimit nga akciza për lëndët djegëse, të përdorura nga subjektet, të cilat ndërtojnë burime të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5MW për burim, për nevojat e veta ose për

shitje brenda vendit, duke respektuar edhe aktet e tjera normative në fuqi, lejohet me kusht që akciza e lëndëve djegëse të përdorura të rimburohet në masën 100% deri në datën 31 dhjetor 2014. Nga data 1 janar 2015 akciza e lëndëve djegëse të përdorura rimburohet deri në masën 80%. Pjesa tjetër prej 20% të përballohet nga ndërmarrjet përfituese.”

“ 2. Investimet që do të përdoren për gjenerimin e energjisë duhet të jenë investime me teknologji moderne që respektojnë të gjitha standardet mjedisore, të përcaktuara në kuadrin ligjor të miratuar nga Republika e Shqipërisë. Ndërmarrjet janë të detyruara të lidhin marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ku të marrin përsipër përmirësimin e eficiencës së tyre për sa i takon respektimit të kushteve mjedisore.”

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

G E N C R U L I